

Përmbledhje e biografisë së Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha ka kryer studimet e larta në Departamentin e Gjuhës Frënge të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe është diplomuar në vitin 1996. Studimet master i ka kryer në Universitetin Denis Diderot - ParisVII në Francë dhe më pas studimet e doktoratës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Prof.Dr. Esmeralda Kromidha ka qenë në poste drejtuese dhe ka dhënë kontribut për institucionin si Zv. Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në vitet 2008-2012, Përgjegjëse e Departamentit të Gjuhës Frënge në vitet 2012-2016, Zv. Rektore e UT që nga shtatori i vitit 2020.

Ajo ka qenë anëtare e Këshillit të Fakultetit në periudhën 2012-2016, anëtare e Sentit Akademik të UT në periudhën 2016-2020, anëtare e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës Doktor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në vitet 2019-2021.

Fushat kryesore hulumtuese të saj janë: Gjuhësi - Didaktika e gjuhëve të huaja, Metodologjia e kërkimit shkencor në mësimdhënie/mësimnxënie të gjuhëve të huaja, Komunikimi në fushën e turizmit.

Prof.Dr. Esmeralda Kromidha ka një kontribut të gjerë në botime dhe referime shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë drejtuese dhe bashkëpunëtore shkencore në projekte kërkimore ndërkombëtare. Ka lektuar në disa universitete të huaja në kuadër të shkëmbimeve Erasmus+.

Gjatë përvojës së saj akademike përveç përkushtimit në mësimdhënie ajo ka qenë drejtuese ose bashkëorganizatore e veprimtarive të shumta mësimore, shkencore dhe kulturore në bashkëpunimin me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha mban titullin “ Personalitet i shquar i frankofonisë” për kontribut në promovimin e gjuhës frënge nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.